



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 108 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendlodur përkufizat me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se më datën 29.04.2012, në fshatin Koshare në Qendrën e Votimit 2515D në vendvotimin numër 04 me kryesues z. Adem Ademi nga subjekti AKR, Selman Selimi nga fshati Koshare si votues që nuk dinte shkrim dhe lexim kërkon nga këshilli i vendvotimit që të i lejohet që të përdorte të drejtën e ndihmës për të votuar. Sipas parashtreesit të ankesës, vëzhguesi i LVV-së reagon dhunshëm dhe i kërkon KVV-së, që le të ja bënë një X ose le të mos voton fare, sipas pretendimit të ankuesit ai insistonte të ja merrte të drejtën e votës edhe për kundër kësaj votuesi votoi vetë pa ja mundësuar ndihmën që ai e kërkonte. Pretenduesi i ankesës theksón se pas kësaj vëzhguesi i PDK-së kërkonte që të respektohet e drejta e votës dhe e drejta e ndihmës së votuesit që nuk dinte shkrim dhe lexim. Pas kësaj vëzhguesi i PDK-së ka regjistruar vërejtjen në librin e Vendvotimit, ka insistuar te kryesusi i KVV-së që të i jepte emrin e vëzhguesit të Vetëvendosjes por nuk i lejon qasje për të mësuar që të dijë emrin e vëzhguesit. Siç ka theksuar parashtreesi i ankesës, ligji i njerëzve që nuk dinë shkrim dhe lexim ja mundëson që ta shprehin vullnetin për të votuar për kandidatin që ai dëshiron dhe dikush nga zyrtarët në procesin e Vendvotimit, është i obliguar që të ndihmojë e kurrsesi të mos ja marrin këtë të drejtë ligjore dhe kushtetuese siq ka ndodhur në këtë rast me votuesin Selman Selimi. Kryesuesi i vendvotimit është pajtuar që vend votimi të bëhet me X që të shpallet i pavlefshëm.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se votuesit Selman Selimi nga fshati Koshare, që nuk ka ditur shkrim dhe lexim, nuk ju ka mundësuar ndihma gjatë votimit. PZAP-i gjeti se pretendimet e tillë ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tillë ankimore, andaj duke marr parasysh ketë, si dhe faktin se në ankesë nuk është dhënë edhe emri e mbiemri i vëzhguesit i cili kinse ka penguar votuesin e lart përmendur që të shfrytëzoi ndihmën e dikujt tjetër me rastin e votimit, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkasat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 108 /2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala

